# RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VETËVLERËSIMIN E STAFIT AKADEMIK

Dhjetor, 2023

## 1. Hyrje

Kolegji Biznesi në Prishtinë, dhe dega në Prizren (këtu e tutje: KB), si Bartes Institucion i Arsimit të Lartë, i themeluar që nga viti 2004, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë.

KB ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë dhe, përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanit, Pergjegjesit e programeve studimore dhe kordinatorëve për cilësi në kuadër të programeve Studimore, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Kolegji Biznesi ka një rol të veçantë në këto zhvillime dhe është organi kryesor brenda KB për matjen e cilësisë së brendshme.

Në muajin dhjetor 2023, në vazhdën e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë brenda KB, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitë e reja, si dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSC-ja ka realizuar pyetësorin për vetëvlerësimin e stafit akademik në KB, si një proces tashmë i institucionalizuar.

I gjithë procesi i lansimit të pyetësorëve dhe i mbledhjes së të dhënave është realizuar nga ZSC-ja. Procesi ka qenë transparent, duke respektuar dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

Më poshtë paraqiten të dhënat e nxjerra nga pyetësori. Me qëllim që raporti të ruajë etikën e secilit individ dhe atë të institucionit, janë publikuar vetëm gjetjet kryesore, ndërsa rekomandimet, si pjesa e fundit e raportit, përmbajnë sugjerime dhe vërejtje të cilat nuk bëhen publike, pasi janë dhënë në mënyrë konfidenciale nga respondentët

## 2. Metodologjia e Pytesorit

Pyetësori për stafin akademik është hartuar dhe realizuar në dhjetor të vitit 2023, në përfundim të semestrit dimëror, nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë e Kolegjit Biznesi (ZSC). Pyetësori ka përfshirë profesorët dhe asistentët e të gjitha programeve studimore të Kolegjit “Biznesi”.

Në këtë proces kanë marrë pjesë 28 respondentë, të cilët kanë plotësuar 28 pyetësorë lidhur me kushtet e punës, rezultatet e punës dhe funksionimin e administratës. Të gjithë respondentët janë përgjigjur për secilën çështje të parashtruar. Pyetësori ka qenë anonim, në përputhje me standardet e etikës dhe konfidencialitetit.

Pyetësori ka përmbajtur gjithsej 23 pyetje me alternativa, nga të cilat:

- ✓ 9 pyetje për kushtet e punës,
- ✓ 9 pyetje për rezultatet e punës, dhe
- ✓ 5 pyetje për administratën,

Me një mundësi zgjedhjeje për secilën pyetje.

ZSC ka realizuar përpunimin e të dhënave në tabelë përmbledhëse, ndërsa grafikonet janë gjeneruar në mënyrë automatike, për të siguruar paraqitje objektive dhe të verifikueshme të rezultateve.

Pyetjet janë dizajnuar për të vlerësuar këto aspekte kryesore:

- Kushtet e punës;
- Informimin e përgjithshëm;
- Proceset e vendimmarrjes;
- Hapësirat, ambientin dhe pajisjet teknologjike;
- Realizimin e objektivave të planprogramit;
- Menaxhimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor;
- Motivimin dhe integrimin brenda Kolegjit;
- Zhvillimin profesional, pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete shkencore;
- Komunikimin dhe informimin nga administrata;
- Sfidat dhe nevojat për përmirësimin e kushteve dhe performances

## 3. Gjetjet nga pyetësori

Pjesëmarrja e stafit akademik në pyetësorin e vitit 2023 vlerësohet si **e** mirë dhe përfaqësuese. Stafi ka treguar gatishmëri për të marrë pjesë në procesin e vetëvlerësimit, duke iu përgjigjur pyetjeve në mënyrë të plotë dhe pa shmangie të temave të caktuara.

Ky raport paraqet vetëm përmbledhjen statistikore të rezultateve dhe rekomandimet që burojnë nga analiza e përgjithshme e përgjigjeve. Ndërkohë**,** raportet e detajuara të përpunuara nga ZSC janë dorëzuar tek Dekani**,** i cili do t'i shqyrtojë dhe diskutojë gjetjet në kuadër të takimeve me stafin akademik, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

Gjetjet kryesore nga disa prej pyetjeve dhe fushave specifike të pyetësorit të realizuar me stafin akademik për vitin 2023 paraqiten në vijim:

**Pyetësori për vlerësimin e kushteve të punës**

Unë jam i/e kënaqur me kushtet e punës të ofruara nga Kolegji:



Unë gjej mbështetje te menaxhmenti për çdo vështirësi dhe sfidë eventuale




Ngarkesa ime e punës është lehtë e menaxhueshme



Unë jam në dijeni për misionin, vizionin dhe qëllimet strategjike të Kolegjit




Unë marrë pjesë në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Kolegjit



Unë jam i/e lirë të shpreh idetë dhe propozimet te menaxhmenti i KB




Hapësira e Kolegjit plotëson kushtet për realizimin e mësimit efektiv



Hapësira është e furnizuar me pajisje adekuate për realizimin e mësimit




Stafi akademik ka qasje të lehtë në shërbimet teknike kur kërkohet



Unë arrij që të prezantoj në mënyrë të saktë qëllimin dhe objektivat e planprogramit




Unë menaxhoj me lehtësi provimet dhe vlerësimet e studentëve



Unë përdori metodologji bashkëkohore të mësimdhënies




Numri i studentëve në sallë është i përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor



Unë ndjehem i/e motivuar për punën time si mësimdhënës në KB




Unë ndjehem i/e integruar brenda Kolegjit



KB organizon mjaftueshëm konferenca shkencore për stafin akademik




KB organizon mjaftueshëm aktivitete për zhvillimin e stafit akademik



Unë jam i/e kënaqur me mundësitë e ofruara nga KB për zhvillimin personal




Komunikimi me administratën është efektiv



Sjellja e zyrtarëve administrativë është korrekte dhe profesionale




Çdo kërkesë e imja përmbushet në kohë të shpejtë nga shërbimi administrativ



Çdo kërkesë e imja përmbushet në kohë të shpejtë nga shërbimi administrativ




Unë informohem në kohë nga administrata për çdo ndryshim të orarit, provimeve apo procesit mësimor



**Disa nga aktivitetet e cekura nga stafi akademik:**

-Organizimi i tryezës së rrumbullaket për fushat ndergjegjesimi per komisionin e etikes.

-Organizimi i trajnimeve per perdorimin e tabelave smart.

## Rekomandimet

Pas analizimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit të stafit akademik dhe komenteve të tyre, Zyra për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Biznesi i rekomandon menaxhmentit të institucionit që të ndërmerren këto masa:

**1. Krijimi i rrjetit të brendshëm akademik në Kolegjin Biznesi**

Të krijohet një rrjet funksional i stafit akademik për shkëmbim përvojash, ide kërkimore, bashkë-autorësi.

**2. Organizimi i vizitave studimore dhe profesionale**

Të mbështeten dhe organizohen vizita studimore në institucione arsimore, kompani dhe organizata partnere, për stafin dhe studentët e Kolegjit Biznesi, me qëllim lidhjen e teorisë me praktikën dhe forcimin e bashkëpunimit me industrinë.